

**DEKLARATË E ZAHIR TANIN, PËRFAQËSUES SPECIAL I
SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM DHE SHEF I UNMIK-ut
RAPORTIM NË KËSHILLIN E SIGURIMIT PËR UNMIK-UN**

NJU JORK, 21 TETOR 2020

z. President,

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Sigurimit,

Gjatë shtatë muajve të kaluar Kosova ka kaluar nëpër sfida të shumëfishta, duke përfshirë edhe pandeminë aktuale globale. Që nga shfaqja e rasteve të para në Kosovë në muajin mars, kriza e COVID-19 ka kaluar nëpër disa faza. Reagimi i parë përfshiu masa të rrepta dhe kufizime të lëvizjes, por më vonë u kalua në një qasje më të relaksuar, duke i vënë theks rimëkëmbjes ekonomike. Pandemia ka pasur valë të vrullshme, por edhe periudha më stabile, ku tani përhapja e saj prapë po shënon rritje. Derisa qeveria e kryeministrit Kurti aplikoi masa shumë të rrepta të kufizimit të lëvizjes në pjesën më të madhe të mandatit të saj të shkurtër gjatë pandemisë, në ditët e fundit të qeverisë së tij këto masa u lehtësuan. Qeveria pasuese e kryeministrit Avdullah Hotit vazhdoi me këtë qasje, duke lehtësuar shumë nga masat e rrepta që më parë ishin në fuqi, dhe duke u fokusuar në rimëkëmbjen ekonomike. Të dyja qeveritë u ballafaquan me realitetin se infrastruktura shëndetësore publike në Kosovë ishte e pamjaftueshme dhe dobët e

pajisur për t'u ballafaquar me pandeminë që përhapej shpejtë. Kjo ndikoi në të gjitha aspektet e reagimit, duke filluar nga hospitalizimi e deri te trajtimi, nga testimi deri te gjurmimi e deri te zbatimi i cilësdo masë tjetër parandalimit. Megjithatë, është me rëndësi të theksohet se sistemi i kujdesit shëndetësor dhe punëtorët shëndetësorë të vijës së parë kanë punuar në mënyrë heroike për të shfrytëzuar më së miri resurset e kufizuara.

Pasojat socio-ekonomike kanë qenë të rënda dhe nuk kufizohen vetëm në treguesit e matshëm makroekonomik. Si sektori formal, ashtu edhe ai joformal në Kosovë kanë kaluar nëpër tronditje të thellë, që veçanërisht ka prekur rininë dhe shkollimin e tyre, femrat dhe bashkësitë e cenushme. Pasojat psikologjike nga ana tjetër ndjehen nga mbarë shoqëria.

Natyrisht, Kosova nuk është lënë vetëm në këtë luftë kundër pandemisë. Bashkësia ndërkombëtare doli në ndihmë për të fuqizuar kapacitetet profesionale dhe institucionale të Kosovës, si dhe për të zbutur ndikimin negativ të pandemisë në shoqëri dhe ekonomi. Gjatë muajit shtator, Komisioni Evropian miratoi pakon e ndihmës financiare në shumë prej 138 milionë euro, nga të cilat 50 milionë janë të orientuara specifikisht për ballafaqim me COVID-19. Këto fonde janë shtesë e përkrahjes tjetër materiale, financiare, të huave dhe të ekspertizës që i është dhënë

Kosovës nga Bashkimi Evropian, Banka Botërore, Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe nga ndihmat e tjera bilaterale.

Ne në UNMIK, së bashku me Ekipin e agjencive, fondeve dhe programeve të OKB-së në Kosovë, dukshëm kemi përshtatur aktivitetet tona për të ndihmuar në tejkalimin e sfidave të papara deri më tani, të dala nga pandemia COVID-19. Përqendrimi ynë ka qenë në ofrimin e përkrahjes së drejtpërdrejtë njerëzve, institucioneve dhe komuniteteve brenda kornizës së përkrahjes strategjike të Misionit për dialog dhe ndërtimin e besimit në Kosovë. Projektet janë përshtatur për t'i kontribuar reagimit ndaj COVID-19.

Ndikimi joproporcional i pandemisë në popullatat tanimë të cënueshme paraqet shqetësim të veçantë. Ka pasur rritje në numrin e raportuar të incidenteve të sigurisë ndaj komuniteteve të cënueshme dhe atyre joshumicë gjatë periudhës së kufizimeve të pandemisë. Gjithashtu është raportuar rritje e dukshme e rasteve të raportuara të dhunës në familje dhe të dhunës ndaj fëmijëve.

z. President,

Heqja e masave të reciprocitetit në mallrat nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina nga qeveria e kryeministrit Hoti krijoi një nxitje për rifillimin e dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës. Kjo u shoqërua me emërimin e përfaqësuesit special të

Bashkimit Evropian, Miroslav Lajčak, dhe me takimin e nivelit të lartë të organizuar më 10 korrik nga presidenti i Francës dhe kancelarja e Gjermanisë që çojë në rifillimin zyrtar të dialogut të përkrahur nga BE-ja. Qeveria e ShBA-ve gjithashtu filloi me nisma të reja për përmirësimin e marrëdhënieve mes Prishtinës dhe Beogradit, të cilat kulmuan me takimin e organizuar nga presidenti i ShBA-ve në shtator, gjatë së cilit u nënshkruan marrëveshje nga sfera ekonomike dhe sfera të tjera. Dëshiroj t'i përgëzoj Beogradin dhe Prishtinën për rifillimin e procesit negociator dhe i ftoj që përkundër sfidave dhe dallimeve të ruajnë procesin konstruktiv të dialogut. Takimet e fundit në Bruksel dhe Uashington tregojnë potencialin për përparim kur resurset ndërkombëtare kombinohen me leadership në terren për t'i çuar përpara çështjet e vështira.

Natyrisht, kushti më i rëndësishëm që duhet të plotësohet që negociatat të kenë sukses është uniteti politik, përkushtimi i fuqishëm dhe vullneti i mirë i udhëheqësve të Prishtinës e Beogradit, si dhe përkrahja e qëndrueshme ndërkombëtare. Ne mirëpresim angazhimin e rifilluar dhe inkurajojmë të dyja palët të gjejnë gjuhë të përbashkët dhe të tejkalojnë çështjet kontestuese, duke arritur një marrëveshje gjithëpërfshirëse të normalizimit.

z. President,

Së bashku me përvjetorin e 75-të të OKB-së, këtë vit po ashtu shënojmë 20 vjetorin e Rezolutës 1325 (2000) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për gruan, paqen dhe sigurinë. Theksoj edhe njëherë rëndësinë e pjesëmarrjes domethënëse të gruas në proceset paqësore në të gjitha nivelet, posaçërisht në dialogun aktual mes Beogradit dhe Prishtinës në kuadër të sigurimit të pjesëmarrjes më të gjerë të sektorëve të ndryshëm të shoqërisë, duke përfshirë rininë dhe komunitetet. Një qasje e tillë do të jetë thelbësore në arritjen e rezultateve dhe ndihmon të sigurohemi që ato t'u përgjigjen nevojave reale të njerëzve.

z. President,

Që nga raportimi im i fundit në Këshill, janë bërë hapa të rëndësishëm për avancimin e proceseve hetimore dhe gjyqësore të Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës dhe të Dhomave të Specializuara të Kosovës. Në qershor, Zyra e Prokurorit të Specializuar publikoi ngritjen e aktakuzave kundër presidentit Hashim Thaçi dhe kundër kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, si dhe kundër disa të tjerëve, emrat e të cilëve nuk janë publikuar. Presidenti Thaçi është deklaruar se do të jep dorëheqje nëse gjyqtarët e procedurës paraprake e konfirmojnë këtë aktakuzë. Në shtator, janë bërë arrestimet në bazë të fletarresteve dhe urdhrave për transfer, të lëshuara nga Dhomat e Specializuara. Tre individë tanimë gjenden në paraburgim, ku njëri prej tyre ballafaqohet me

akuza të krimeve të luftës. Dy të tjerët mbahen nën dyshimin për ngacmim, hakmarrje, shkelje të sekretit të procedurave dhe publikim të paligjshëm të informatës së mbrojtur. Dy nga këto arrestime kanë pasuar pas publikimit të dokumenteve që pretendohet se kanë rrjedhur nga Prokuroria, ku gjithashtu pretendohet se janë përfshirë edhe emrat e dëshmitarëve të mundshëm.

Disa reagime publike në Kosovë ndaj publikimeve të qershorit të aktakuzave të profilit të lartë kanë qenë shqetësuese, duke përfshirë tentimet për vënie në pyetje të legjitimitetit të Dhomave të Specializuara dhe akuzat se janë politikisht të motivuara. Fatkeqësisht, disa udhëheqës politik jo gjithmonë kanë ndihmuar në korigjimin e këtyre deklaratave të rreme.

z. President,

Siç është e qartë për të gjithë anëtarët e këtij Këshilli dhe për bashkësinë ndërkombëtare, Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar janë pjesë përbërëse e sistemit gjyqësor të Kosovës me mandate thelbësore për aspiratat e sundimit të ligjit në Kosovë dhe për të ardhmen e Kosovës. Së këndejmi, dëshiroj të shfrytëzoj mundësinë për t'i nxitur udhëheqësit që t'i rrisin përpjekjet në kundërshtimin e keqinformimit dhe që të sigurohen se procedurat para Prokurorisë dhe Dhomave të kenë përkrahjen e palëkundur të

institucioneve dhe atë politike, e cila është thelbësore për fuqizimin e sundimit të ligjit dhe stabilitetin afatgjatë në Kosovë.

z. President,

Duke udhëhequr me një shumicë të vogël, qeveria e tanishme e udhëhequr nga kryeministri Hoti kundërshtohet nga një opozitë mjaft e madhe, si dhe nga prioritetet e ndryshme brenda partnerëve të koalicionit. Duke qenë në detyrë për pak më shumë se 100 ditë, mospajtimet e vazhdueshme në mes të partive të pozitës dhe vështirësitë për gjetjen e kompromiseve, kanë penguar dhe vonuar reagimet në të gjitha fushat kritike që i kam theksuar.

z. President,

Në historinë 75-vjeçare të Kombeve të Bashkuara, ai asnjëherë më parë nuk është shfaqur qartë nevoja për solidaritet global dhe bashkëpunim ndërkombëtar ashtu siç po shfaqet sot. Pandemia COVID-19, tensionet gjeopolitike dhe etnike të shprehura në konflikte në mbarë botën, si dhe pabarazia në rritje janë trendë që e fuqizojnë njëri-tjetrin në aspektin negativ. Për vendet siç është Kosova që ende vuan nga pasojat e konfliktit të armatosur – **bashkëpunimi; unifikimi i zërit dhe vizionit politik; dialogu dhe parandalimi i polarizimit të skajshëm duhet të jenë prioritetet e nivelit më të lartë.** Ky solidaritet, posaçërisht gjatë pandemisë së tanishme, duhet të fokusohet intensivisht në arritjen e ekuilibrit të vështirë mes

shëndetit publik, rimëkëmbjes ekonomike dhe të drejtave të njeriut që paraqet enigmën më të madhe për qeveritë e mbarë botës.

Në këtë vazhdë, dëshiroj të përmbyll raportimin duke ritheksuar përkushtimin e UNMIK-ut në përkrahje të dialogut të mbështetur nga BE-ja dhe të përpjekjeve të udhëheqësve të të dyja palëve për të ecur me vendosmëri drejt një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe një paqeje e pajtimi afatgjatë.

I falënderoj të gjithë anëtarët e Këshillit për vëmendjen e tyre dhe për përkrahjen e vazhdueshme të UNMIK-ut.

Ju faleminderit